

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR
PROCEDURËN E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
SHËRBIME¹²**

“Studim-Projektim për objektet e ndërtimit”

TIRANË

2026

¹ Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti /enti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

² Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.

NJOFTIME

NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

(Për t'u Plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor;

Emri _____

Adresa _____

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

☐

Njësi e autoriteteve vendore

☐

Institucioni i pavarur

☐

Të tjera

☐

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja
të veta

☐

I deleguar

☐

Organ Qendror blerës

☐

Ofrues shërbimi

Publik

☐

Privat

☐

Të tjera

☐

1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: _____

Tel/faks _____

E-mail _____

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: _____

1.7 Tipi i kontratës: _____

1.8 Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare) :

1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër:

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:

1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____

NJOFTIMI I KONTRATËS

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri:	Bashkia e Tiranës
Adresa:	Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Tel/Faks:	+355 4 22 56 799
E-mail:	Prokurime@tirana.al
Adresa e ueb-faqes:	www.tirana.al
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	D.P V.M

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

☐

Institucioni i pavarur

☐

Njësi e autoriteteve vendore

X

Të tjera

☐

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta

X

Organ Qendror blerës

☐

Ofrues shërbimi

Publik **X** Privat ☐

I deleguar

☐

Të tjera

☐

1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po

☐

Jo

X

1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po

☐

Jo

X

1.6 Kontratë e rezervuar :

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

Seksioni 2:

Objekti i Kontratës: “Studim-Projektim për objektet e ndërtimit”, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësinë Administrative Nr.1 dhe Nr.9”;

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë”;

Loti i III-të: Studim-Projektim për objektin: “Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agolli”;

Loti i IV-të: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka”;

Loti i V-të: Studim-Projektim për objektin: “Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja”;

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF -97266-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të I-rë: REF-97273-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të II-të: REF- 97276-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të III-të: REF- 97279-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të IV-të: REF- 97283-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të V-të: REF-97286-08-25-2026

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 71000000-8, Shërbime arkitektonike, inxhinierike, ndërtimi dhe inspektimi.

2.3 Lloji i Kontratës: “Kontratë Publike për Shërbime”

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po ☐ Jo ☒

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

Me një Operator Ekonomik ☐

Me disa Operatorë Ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po ☐ Jo ☐

2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e për zgjedhjes

--

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ____ (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

--	--	--

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **14,958,281.5** (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë pesë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **161,658.72** Euro pa TVSH, e ndarë në lote si më poshtë vijon:

- **Loti i I-rë:** Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësine Administrative Nr.1 dhe Nr.9” me fond limit **4,331,478** (katër milion e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **46,811.60** Euro pa TVSH.
- **Loti i II-të:** Studim-Projektim për objektin: “Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë” me fond limit **673,310.76** (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **7,276.67** Euro pa TVSH.
- **Loti i III-të:** Studim-Projektim për objektin: “Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agolli” me fond limit **252,491** (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **2,728.74** Euro pa TVSH.
- **Loti i IV-të:** Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka” me fond limit **8,048,310.74** (tetë milion e dyzet e tetë mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **86,980.55** Euro pa TVSH.
- **Loti i V-të:** Studim-Projektim për objektin: “Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja” me fond limit **1,652,691** (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **17,861.13** Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24/08/2026 është 92.53 Euro.**

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është _____**

3. Burimi i financimit: *të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB Nr. 100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2026” (i ndryshuar), i miratuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. Prot. 43563/1, datë 24.12.2025.*

4. Kodi Output: **Kodi Output:**

- **Loti I**

Kodi Output: 1013492 Vlera: **4,331,478** lekë pa TVSH /**46,811.60** Euro

- **Loti II**

Kodi Output: 1013594 Vlera: **673,310.76** lekë pa TVSH/ **7,276.67** Euro

- **Loti III**

Kodi Output: 1013589 Vlera: **252,491** lekë pa TVSH/ **2,728.74** Euro

- **Loti IV**

Kodi Output: 1013370 Vlera: **8,048,310.74** lekë pa TVSH/ **86,980.5** Euro

- **Loti V**

Kodi Output: 1013359 Vlera: **1,652,691** lekë pa TVSH/ **17,861.13**Euro

5. Tipi:

- **Loti I**

Investime ☐ Kodi: _____ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 231 Vlera: **4,331,478** lekë pa TVSH/**46,811.60** Euro

- **Loti II**

Investime ☐ Kodi: _____ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 231 Vlera: **673,310.76** lekë pa TVSH/**7,276.67**Euro

- **Loti III**

Investime ☐ Kodi: _____ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 231 Vlera: **252,491**lekë pa TVSH /**2,728.74** Euro

- **Loti IV**

Investime ☐ Kodi: _____ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 231 Vlera: **8,048,310.74** lekë pa TVSH /**86,980.5** Euro

- **Loti V**

Investime ☐ Kodi: _____ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 231 Vlera: **1,652,691**lekë pa TVSH /**17,861.13** Euro

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësinë Administrative Nr.1 dhe Nr.9” **12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik.**

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë” **5 (pesë) muaj kalendarik.**

Loti i III-të: Studim-Projektim për objektin: “Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agolli” **2 (dy) muaj kalendarik.**

Loti i IV-të: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka” **10 (dhjetë) muaj kalendarik.**

Loti i V-të: Studim-Projektim për objektin: “Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja” **4 (katër) muaj kalendarik.**

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: ____ ose ditë: ____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër) Ose fillon më ____ / ____ / ____ (d/m/v) mbaron më ____ / ____ / ____ (d/m/v)
--

2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:

Në Territorin e Bashkisë Tiranë

2.13 Ndarja në Lote:

Po

X

Jo



Nëse po,

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësinë Administrative Nr.1 dhe Nr.9” me fond limit **4,331,478** (katër milion e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **46,811.60** Euro pa TVSH

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë” me fond limit **673,310.76** (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **7,276.67** Euro pa TVSH

Loti i III-të: Studim-Projektim për objektin: **“Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agoli”** me fond limit **252,491** (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **2,728.74** Euro pa TVSH.

Loti i IV-të: Studim-Projektim për objektin: **“Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka”** me fond limit **8,048,310.74** (tetë milion e dyzet e tetë mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **86,980.55** Euro pa TVSH.

Loti i V-të: Studim-Projektim për objektin: **“Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja”** me fond limit **1,652,691** (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **17,861.13** Euro pa TVSH.

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24/08/2026 është 92.53 Euro.*

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

☐ një Lot,

☐ disa Lote,

X të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi _____

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

Po

☐

Jo

X

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

2.15 Pranohen variantet:

Po ☐ **Jo** **X**

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po ☐ **Jo** **X**

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po ☐ **Jo** **X**

Shënime të tjera *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po ☐ **Jo** **X**

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e sigurimit të ofertës për 5 lotet është **299,165.63** (Dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë / **3,233.17** Euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24/08/2026 është 92.53 Euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti i I-rë: 86,629.56 (Tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë pikë pesëdhjetë e gjashtë) lekë / **936.23** Euro.

Loti i II-të: 13,466.21 (Trembëdhjetë mijë e katërtqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e një) lekë / **145.53** Euro.

Loti i III-të: 5,049.82 (pesë mijë e dyzet e nëntë pikë tetëdhjetë e dy) lekë / **54.57** Euro.

Loti i IV-të: 160,966.21 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e një) lekë / **1,739.61** Euro.

Loti i V-të: 33,053.82 (tridhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e dy) lekë / **357.22** Euro.

3.1.2 Autoriteti/ Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor **4662102** *(të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)*

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.

Seksioni 4: Procedura

4.1 Lloji i procedurës: “Procedurë e Hapur” mbi kufirin e lartë monetar.

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit:
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit :
- c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)³ Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Kriteret e Vleresimit

Pikët

1. Çmimi më i ulët

[0 - 50]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

2. Propozimi teknik

[0 - 50]

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Propozimit teknik

(i) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[0 - 10]

Operatori ekonomik përmes kualifikimeve dhe përvojës së stafit kryesor, garanton realizimin cilësor të shërbimit që do të kryhet. Përgatitja e tyre teknike dhe eksperiencia në shërbime të ngjashme siguron Autoritetin Kontraktor zbatimin e qëndrueshëm të kontratës.

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b- Eksperiencia në fushën përkatëse

Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

Eksperiencia në fushën përkatëse përfshin: eksperiencia në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë: Kualifikimin i përgjithshëm i cili përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) Metodologjia e Propozuar

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

(Përfaqja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

- Përfaqja teknike dhe metodologjia: Operatori ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë dhe mënyrën e zbatimit të shërbimeve. Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e shërbimit. Për

të plotësuar këtë kriter ofertuesit duhet të paraqesin një dokument i cili duhet të përfshijë menyrën e realizimit dhe metodologjinë, si dhe burimet e nevojshme për realizimin e shërbimit sipas metodologjisë perkatese. Dokumenti duhet të përshkruajë qasjen e kontraktorit, risqet e zbatimit të kontratës, indikatorët cilësorë dhe sasiorë për realizimin e qëllimit të shërbimit, rezultatet e pritshme, sigurimin dhe kontrollin e cilësisë, sigurimin teknik dhe shëndetit në punë, raportimin, metodologjinë e dorezimit të objektit në përputhje me legjislacionin dhe standartet në fuqi etj. (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës apo detyrën e projektimit).

- **Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.
- **Organizimi dhe Staf:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Përvoja për Punë të Ngjashme

[0 - 20]

Ky kriter i garanton Autoritetit Kontraktor garanci për një proces të qëndrueshëm mbikqyrje, me menaxhim efektiv të situatave dhe zbatim të rregullt të kontratës së punimeve. Projektet e përfunduara mbi nivelin minimal të kërkuar dëshmojnë aftësi organizative dhe përgatitje të kapaciteteve të Operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Operatorët ekonomikë, do të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin dhe që janë realizuar në periudhën kohore brenda tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, do të akordohen pikët maksimale. e prokurimit. Operatori ekonomik për t'u vlerësuar për këtë kriter i cili do të paraqesë kontrata me vlerën më të lartë për objekte të ngjashëm përtej minimumit të percaktuar në kriterin e kualifikimit pika 2.3 Shtojca 9

Përvoja për punë të ngjashme garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të shërbimit të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/kontratat e ngjashme të kryera përtej minimumit të kërkuar garantojnë AK që me qëndrueshmërinë në treg, eksperiencën e stafit teknik dhe përvojën e duhur të vetë organizatës si dhe kapacitetin e lartë teknik kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së shërbimeve.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të

mësipërme.

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + Pk4 \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertes së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/Pk4... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për kriterin e cmimit përllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min k1} \times P_{max k1} / O_{k1}$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min k1} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max k1} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi *(Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të vlerësuar).*

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 25/09/2026 ora 10:00

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42, pika 6, të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po



Jo

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

X

Seksioni 5: Informacione shitesë:

5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po



Jo

X

Nëse po

Monedha

Çmimi

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

5.2 Informacione shitesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi **26/08/2026**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrit]

FTESË PËR OFERTË

(shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve të kërkuara:

Vendi i kryerjes së shërbimit: (jepni një përshkrim të shkurtër) _____

Kohëzgjatja e shërbimit: _____

Ofertat duhet të paraqiten në:

.....[jepni adresën e saktë]

Afati i fundit për pranimin e ofertave:

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Forma shkresore ☐

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) ☐

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në
Buletinin e Njoftimeve Publike)*

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri Bashkia e Tiranës

Adresa Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001

Tel/Faks 00 355 4 22 56 799

E-mail Prokurime@tirana.al

Ueb-faqe www.tirana.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur” mbi kufirin e lartë monetar

3. Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF -97266-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të I-rë: REF-97273-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të II-të: REF- 97276-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të III-të: REF- 97279-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të IV-të: REF- 97283-08-25-2026

Numri i referencës së lotit të V-të: REF-97286-08-25-2026

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Studim-Projektim për objektet e ndërtimit”,
të ndarë në lote si më poshtë vijon:**

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësinë Administrative Nr.1 dhe Nr.9”

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë”

Loti i III-të: Studim-Projektim për objektin: “Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agolli”.

Loti i IV-të: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka”

Loti i V-të: Studim-Projektim për objektin: “Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 71000000-8, Shërbime arkitektonike, inxhinierike, ndërtimi dhe inspektimi.

6. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 14,958,281.5 (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë pesë) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB Nr. 100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2026” (i ndryshuar), i miratuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. Prot. 43563/1, datë 24.12.2025.

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “**Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësinë Administrative Nr.1 dhe Nr.9**” me fond limit **4,331,478** (katër milion e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet **46,811.60** Euro pa TVSH

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “**Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë**” me fond limit **673,310.76** (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **7,276.67** Euro pa TVSH

Loti i III-të: Studim-Projektim për objektin: “**Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agolli**” me fond limit **252,491** (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **2,728.74** Euro pa TVSH.

Loti i IV-të: Studim-Projektim për objektin: “**Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka**” me fond limit **8,048,310.74** (tetë milion e dyzet e tetë mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **86,980.55** Euro pa TVSH.

Loti i V-të: Studim-Projektim për objektin: “**Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja**” me fond limit **1,652,691** (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **17,861.13** Euro pa TVSH.

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24 /08/2026 është 92.53 Euro.**

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim kopshte dhe çerdhe të integruara në Njësine Administrative Nr.1 dhe Nr.9” *12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik*

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Instalimi i Sistemit Fotovoltaik (ONGRID) në shkollën 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, Tiranë” *5 (pesë) muaj kalendarik*

Loti i III-të: Studim-Projektim për objektin: “Restaurim Shtëpia Studio Kadare-Agolli” *2 (dy) muaj kalendarik*

Loti i IV-të: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkolle e mesme (Tipi 4) Njësia Strukturore TR/36, rruga “Muharrem Butka” *10 (dhjetë) muaj kalendarik*

Loti i V-të: Studim-Projektim për objektin: “Përshtatje e hapësirave të Kopshtit Zoologjik në funksion të shtimit të llojshmërisë së kafshëve të reja” *4 (katër) muaj kalendarik*

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data 25/09/2026 Ora: 10:00

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit:
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit :
- c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit:

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I

KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Shërbime: Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____		
Numri i kontratës	Titulli i kontratës	Përshkrimi i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit : _____

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumenteve të tenderit:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _____

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentet e tenderit.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit: _____

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): _____

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri _____

NIPT: _____

Adresa _____

Kontaktet _____

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: _____

16. Burimi i financimit: _____

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor _____

DOKUMENTET E TENDERIT

Përmbajtja:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontratës.

Seksioni II: Shtojcat

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilat duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, termat e references, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

Seksioni III. Termt dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

Seksioni IV: Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i prokurimit

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.
2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm

a) “Operator ekonomik” është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

- 1.1 të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;
 - 1.2 BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.
- b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator

ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sic është bërë publikimi i Dokumentave të Tenderit.
3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

1. Shpenzimet e ofertimit

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

2. Gjuha e Ofertës

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një

pjesë në gjuhën angleze.

3. Dokumentet përbërëse të Ofertës

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar.

5. Ofertat Alternative

Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

6. Çmimet

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre.

3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimet pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë

dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

5. Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

7. Monedhat

Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.

8. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

9. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme:

a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor;

b) Garanci bankare;

c) Garanci sigurimi.

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Entin Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së

vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.

Nëse autoriteti/Enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra siguri i ofertës së tij nuk konfiskohet.

10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

11. Paraqitja e Ofertave

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për kryerjen e Shërbimeve; Njoftimi Nr. ____.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA -----
--- d/m/v, në orën-----”.**

12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e

pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

13. Ofertat me vonesë

Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimi të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

